



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.Shk II.nr.1106/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përmbartimore të kreditorit EXCLUSIVE Sh.p.k, me nr. të biznesit 810502246 me seli në Zona Industriale Prishtinë – Fushë Kosovë, rr. “Aziz Abrashi” nr. 86, kundër debitorit Dea Sh.p.k, me nr. unik të biznesit 810975766 me seli në Prizren, rr. “William Walker” p.n, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.908/22 të datës 30.05.2023, me datë **05.03.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit EXCLUSIVE Sh.p.k, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.908/22 të datës 30.05.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkallës së parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.908/22 të datës 30.05.2023 në pikën I të dispozitivit e ka pranuar si të bazuar prapësimi i debitorit Dea Sh.p.k, me seli në Prizren ashtu që ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.1249/21 i datës 20.09.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Isa Gacaferri dhe është përfunduar në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, (*me pretendime sikur në ankesë*), për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përmbartimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, aktvendimin e ankimuar ta ndryshoj dhe çështjen ta kthej në shkallë të parë në rivendosje.

Ankesa e kreditorit i është dorëzuar debitorit për përgjigje, mirëpo i njëjti nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- **Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori EXCLUSIVE Sh.p.k, me datën 17.09.2021, ka paraqitur propozimin për përmbarrim në bazë të dokumentit të besueshëm dhe atë faturës nr. IL18-06358 e datës 13.08.2018 duke detyruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të Urdhrit, t'ia paguaj kreditorit shumën e papaguar nga fatura e lartcekur në vlerë prej 569.63 EUR (pesëqind e gjashtëdhjetë e nëntë euro e gjashtëdhjetë e tre euro cent) nga arritja për pagesë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore.

Përmbarruesi Privat Isa Gacaferri me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbarrim të kreditorit me urdhrin përmbarrimor P.nr.1249/21, dt.20.09.2021 e ka lejuar përmbarrimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitorin brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarrimor me arsyetimin se kemi të bëjmë me një të drejtë të parashkruar të kreditorit dhe se shumata e kërkuar përmes propozimit për përmbarrim nuk përputhet me shumën sipas faturës. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet si i bazuar prapësimi dhe të shfuqizohet urdhri përmbarrimor.

Përgjigje në prapësim ka parashtruar kreditori duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit me arsyetimin se në rastin konkret kemi të bëjmë me ndërprerje të parashkrimit për shkak se debitorin, përgjatë vitit 2019 ka realizuar pagesa tek kreditori, si dhe pagesa e fundit është bërë me datë 19.01.2021 në shumë prej 300,00 euro në emër të faturës së kërkuar për përmbarrim, andaj në rastin konkret kemi të bëjmë me ndërprerje të parashkrimit përmes pranimit të borxhit. Tutje ka shtuar se në rastin konkret afati i parashkrimit duhet llogaritur me afat pesë (5) vjeçar sipas nenit 352 të LMD-së dhe jo afatin tre (3) vjeçar sipas nenit 355 të LMD-së. Me kërkesë që prapësimi të refuzohet ndërsa Urdhri Përmbarrimor P.nr. 1249/21 i datës 20.09.2021 të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.908/22 të datës 20.09.2021 ku në pikën I të dispozitivit e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Dea Sh.p.k, me seli në Prizren ashtu që ka anuluar urdhrin përmbarrimor P.nr.1249/21 i datës 20.09.2021, i lejuar nga Përmbarruesi Privat Isa Gacaferri dhe është përfunduar në tërësi përmbarrimi në këtë çështje përmbarrimore.

Në arsyetimin të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se borxhi që rrjedh nga Fatura nr. IL18-06358 është përfshirë në parashkrimin pasi që nga koha kur borxhi sipas faturës të lartcekur është bërë i arritshëm me datë 13.08.2018 e deri në iniciimin e procedurës përmbarrimore me datë 17.09.2021, kanë kaluar tre (3) vite e një (1) muaj, duke iu referuar nenit 355 par.1 dhe par.2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata në shkallë të parë drejtë ka vendosur sa i përket parashkrimit të borxhit sipas faturës IL18-06358 e datës 13.08.2018 e lëshuar me datë 13.08.2018, ndërsa propozimin përbarim mbi bazën e kësaj fature kreditori e ka paraqitur me datë 17.09.2021, ashtu që sipas dispozitës së nenit 355 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji Nr.04/L-077), në të cilën parashihet afati 3 (tre) vjeçar i parashkrimit për kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve lidhur me këto kontrata, ndërsa parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer. Ndërsa me nenin 368 të LMD-së është përcaktuar se “Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit”.

Bazuar në dispozitat e lartcekura, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, kur ka pranuar prapësimin me arsyet se urdhri për përbarim është lejuar mbi bazën e faturës e cila është parashkruar sepse nga data e lëshimit të faturës e deri në paraqitjen së propozimit për lejin e përbarimit kanë kaluar 3 vite e një muaj.

Tutje, Dhomat e Shkallës së Dytë sa i përket pretendimeve të debitorit se parashkrimi është ndërprerë me arsyetimin se debitori ka pranuar borxhin përmes pagesave të kohë pas kohshme, ku pagesa e fundit është bërë nga debitori me datë 19.01.2021 vlerëson si pretendime të paqëndrueshme pasi që dokumenti kartelë e debitorit nr. 4199 e bashkangjitur nga kreditori në përgjigje ndaj prapësimin, paraqet dokument të njëanshëm të lëshuar nga ana e kreditorit nga i cili nuk mund të vërtetohet nëse debitori vërtetë ka paguar një pjesë të borxhit që rrjedh nga fatura nr. IL18-06358.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e shkallës së dytë
K.DH.Shk II.nr.1106/23 me datë 05.03.2024

Gjyqtari,
Faton Bajrami